



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XXX-të (tridhjetë – mandati VI) e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 14 dhjetor 2020

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e re e Komunës, dhe filloi në orën 10;50.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi Albina Avdiu Kryesuese e Komitetit,

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: Valbona Kadriu-Podvorica, Benjamin Ejupi, Bashkim Sylja, Doruntina Hasani, ndërsa munguan Valmire Lahu, Mefail Rama dhe Radisav Perović.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin, Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, Bashkim Bajrami nga Policia Rajonale Kufitare dhe Eomed Cylla përfaqësuese nga LMT KFOR.

Rendi i ditës

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, e hapi mbledhjen duke iu uruar mirëseardhje të pranishmëve dhe shëndet të mirë, ndër të tjera theksoi, jemi në dijeni se ditëve të fundit kemi numër të madh të të infektuarve me Covid-19 në përgjithësi në Republikën e Kosovës dhe në territorin e Komunës së Podujevës, andaj shpresojmë që të zbatohen masat dhe të behet kujdes në këtë aspekt, duke shpresuar që ta kalojmë këtë situatë të pandemisë pa pasoja më të mëdha në njerëz.

Rendin e ditës e keni marrë të gjithë me kohë, andaj e hapi debatin, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e vë në votim.

Njëzëri u miratua rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës.

1. Procesverbalet nga mbledhjet e Komitetit për Komunitete të mbajtura më 11 nëntor 2020 dhe 25 nëntor 2020

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime u miratuan procesverbalet e mbajtura më 11 nëntor 2020 dhe 25 nëntor 2020.

2. Shqyrtimi i mundësive për furnizim me lëndë djegëse për ngrohje për familjet në nevojë të cilat janë raste sociale.

znj. Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, pra siç e dimë është mbledhja e dyte radhazi që po e diskutojmë këtë pikë të rendit të ditës mirëpo sot nuk do të jetë askush nga sektori i shëndetësisë dhe mirëqenies sociale dhe sektori i bujqësisë për shkak se siç jemi në dijeni për situatën e krijuar e që drejtorët e këtyre drejtorive ende nuk janë emëruar por shpresojmë se ditëve të ardhshme do të jenë prezent. Pra ashtu siç ne e dimë shumica e pjesëtareve të komunitetit jo shumicë në Komunën e Podujevës janë të varur prej një skeme sociale dhe gjendja e tyre socio-ekonomike është e vështirë për ta, pra në këtë kohë pandemie jo vetëm komunitetet RAE por edhe komuniteti jo shumicë kanë nevojë për ndihmë dhe mbështetje por ndoshta më të fokusuarit janë komuniteti RAE për shkak të gjendjes pandemike, nevojave dhe për shkak se ndihma për këto komunitete ka qenë jo edhe aq e madhe.

z. Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, e dimë që tani demokracia, pluralizmi politik është çështja më demokratike në botë, ndërrohet edhe pushteti e që shfrytëzoj rastin t'ju uroj pushtetin e ri. Normale që shërbimet në kuptimin e atyre civile nuk kanë ndryshuar dhe informacionet nuk mungojnë dhe duke u bazua në këto unë kam pasur kontakte edhe me drejtorin e Drejtorisë së shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS me obligimin e juaj me theks të z. Bashkim Sylja, që më kanë detyruar hapur që unë të merrem me këtë çështje e cila është temë e ndjeshme dhe normale që kam kontaktuar edhe me DSHMS-në, pastaj kam shkuar edhe në Qendrën për Punë Sociale-QPS dhe do t'ju prezantoj me shifra të sakta por jo të argumentuara si dhe në bazë të diskutimeve që kam pasur me DSHMS-në konkretisht me sektorin për çështje sociale si dhe me drejtorin e Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural i cili normal që më kanë dhënë një përgjigjeje që Agjencioni Pyjor i Kosovës ka një deponi që është e krijuar me lëndë djegëse/dru për ngrohje, por që në kuptimin ligjore është e pa mundur të shpërndahen përveç nëse me ndonjë marrëveshje/memorandum mirëkuptimi rregullohet kjo çështje, për ato familje që kanë shumë nevojë, veçmas në këtë situatë për të cilën jemi në dijeni të gjithë rreth pandemisë e cila normal që ka shkaktuar pasoja edhe tek ne ashtu sikurse në gjithë globin, madje edhe në shtetet më të zhvilluara që janë edhe ne sot.

Të gjithë jemi të kyqur nëpër rrjete sociale dhe kemi qasje në qdo kohë në media të shkruara dhe elektronike dhe jemi dëshmitar të ndihmave të ndryshme që jepen në forma të ndryshme të gjithë njerëzve që janë në nevojë e që në nevojë janë shumica e popullatës mund të them sepse bazuar në këtë trendë që po jetojmë dhe në këtë situatë që dashtë Zoti ta kalojmë në vitin që vjen dhe të stabilizohet gjendja dhe situata qoftë shëndetësore qoftë ekonomike dhe sociale sepse ne e dimë që shumë njerëz kanë nevojë, madje edhe për gjera elementare të jetesës, dhe në këtë kontekst edhe stina e dimrit si sezone që është me të ftohtë e që nuk pyet se i ke mundësit apo nuk i ke, nëse mund ta quaj kështu.

Në bazë të këtyre temave që unë kam diskutuar me këto dy Drejtoritë e lartcekura dhe me QPS-në, kam marrë edhe shifrat e sakta e që dëshiroj t'ju them se në bazë të kësaj është paksa shifër alarmante se sa njerëz janë në gjendje jo të mirë, dhe në këtë kontekst nëse dikush e thotë se është në asistencë sociale vetë kuptohet se që është i varur prej shtetit, ndihmave e të cilat nuk janë të mjaftueshme për kokën e familjarëve por megjithatë unë e quaj si mbijetesë, prandaj duke u bazuar në këto rrethana që unë po i potenco dua t'ju jap edhe shifrat. Vlen të theksohet se ne shpeshherë kemi kërkuar edhe donatorë sepse normal që në këtë sistemin që jetojmë ne, e që unë e kam përjetuar edhe sistemin e kaluar, por që tani në demokraci apo pluralizëm është një bashkëpunim mes institucioneve qendrore dhe atyre lokale, por ka edhe donacione të ndryshme,

Shoqatat të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që e marrin aktivitetin për të ndihmuar njerëz në forma të ndryshme, fjala është në kuptimin human që janë donatorët, bizneset e mëdha që janë bamirëse sa i përket ndihmave për të tjerët, prandaj duke u koordinuar në këtë sistem që është sistem jo i komplikuar por është sistem i menaxhuar, atëherë institucionet mund të bëjnë ftesë edhe donatoreve edhe shoqatave për t'i ndihmuar njerëzit në nevojë.

Pra shifrat që i ceka për familje që marrin asistencë sociale në QPS të evidentuara, sipas komuniteteve shqiptarë, ashkalinjë, rome, egjiptasë, sipas anëtareve të familjes dhe sa familje janë: -Komuniteti shqiptar janë 875 familje (4013 anëtarë) në asistencë sociale.

-Komunitetit ashkalinjë që me shifra prinë sa i përket komuniteteve jo shumicë, janë 72 familje (386 anëtarë) që marrin asistencë sociale, e që asistencë sociale nuk e përmbush as minimumin e minimumit, pra janë 386 anëtarë që kanë nevojë për ndihmë. - Komuniteti tjetër jo shumicë rom, janë 5 familje (36 anëtarë) që janë në asistencë sociale. Të komunitetit egjiptas nuk kanë asnjë anëtarë që janë me asistencë sociale, kurse komunitete tjera deri tani nuk kemi në Komunën e Podujevës. Duke u bazuar në krejt këto shifra që unë i thash, në asistencë sociale janë 952 familje me 4435 anëtarë gjithsej, të dhëna këto që janë zyrtare të marra nga QPS e cila merret me asistencë sociale përkatësisht me ndihmë për të gjitha këto familje, ndihmë e cila është me dru për ngrohje, pako ushqimore dhe higjienike e të tjera.

Do të doja shumë që të ishin prezent këtu edhe drejtorët e 2 Drejtorive përkatëse ose ndonjë përgjegjës që merret me këto familje. Bota e qytetëruar e shtrinë dorën e ndihmës dhe iu ndihmon atyre që kanë nevojë, Shoqatat ndërkombëtare që kanë një eksperience 20 vjeçare qëndrojnë në Kosovë për t'i ndihmuar njerëzit sepse nuk janë këtu për të përfituar, kurse të gjithë jemi në dijeni se sa vonoj të miratohet (sa herë doli në Parlamentin e Kosovës) Ligji për rimëkëmbje ekonomike, çështje e cila tani edhe është bërë temë në shoqëri, prandaj edhe ne si Komitet për Komunitete nuk jemi organ që marrim vendime por mund të diskutojmë dhe të dalim me një përfundim të cilin pastaj mund ta përkthejmë në rekomandim për organeve vendimmarrëse (Kuvendin e Komunës, Ekzekutivin e Komunës, Drejtoritë përkatëse dhe të tjera), e që bëjë thirrje t'i thërrasin mendjes dhe ta kuptojnë që njerëzve duhet t'i ndihmojmë, veçmas në këto situata alarmante siç është kjo nga pandemia e cila tani veç se është në rritje globale, e që as ne si shtet dhe si komunë nuk po mund t'i rezistojmë, madje Komuna e Podujevës tani është në listën e kuqe si zonë e rrezikshme, virus i cili e ka marr një trend e që do të është problematike, asnjë njeri nuk është imun dhe asnjë prej neve nuk mund ta kuptojmë se a jemi të infektuar apo jo, dhe në këto rrethana dhe situata që ne po jetojmë ne nuk mund ta dimë se kur është përfundimi, edhe pse siç jemi të njoftuar Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe e morën një hap jashtëzakonisht të madh sa i përket vaksinës, mirëpo tani sa zgjatë kjo vaksinë deri sa të vie edhe në Kosovë mund të ketë pasoja katastrofale sepse nuk mund të mbijetojmë shumë. Pastaj jemi në dijeni se si funksionojmë me sistemin e medikamenteve shëndetësore dhe në këtë kontekst më thoni dikush që ata që janë me gjendje të rëndë sociale dhe në asistencë sociale dhe që nuk kanë asnjë burim tjetër të të ardhurave, si mund të mbijetojnë, si mund të shkojnë për trajtim në Institutin Kombëtar të Shëndetit Publik të Kosovës, pastaj kemi edhe institucione shëndetësore private, pra të gjitha medikamentet nuk gjinden në institucione publike shëndetësore apo nuk janë të mjaftueshme, në ato private nuk kanë mundësi të shkojnë për trajtim sepse është kosto e lartë, (pra de facto, de juro ai që nuk ka të mira materiale po u dashka të vdes) e që është një e padrejtë njerëzore dhe kjo është problemi me i madh tek ne, ndërsa ne sërish merremi se si t'i ndihmojmë njerëzit me pako ushqimore, dru për ngrohje e të ngjashme. Shumë do të doja shumë të isha në bordin e drejtorëve dhe atyre që duhet të marrin veprime për

të intervenuar emergjent për këto çështje dhe për njerëz që nuk e kanë një gjendje të mirë materiale edhe shëndetësore.

znj.Doruntina Hasani, theksoi, desha të shtoj që edhe nëse është ndërruar pushteti besoi që zyrtarët janë të njëjtë dhe është një përgjegjësi ndoshta edhe prej tyre me ardhë këtu dhe me i informuar drejtorët përkatës të Drejtorive që të marrin një vendim, e them këtë meqë drejtorët e drejtorive tashmë janë, por dimri nuk pret, komunitetet jo shumicë janë në gjendje të keqe, ndoshta është mirë vetëm një kërkesë me shkrim t’iu bëhet edhe pse ne po marrim qëndrim që të komunikohet me Drejtoritë përkatëse që të miratohet ky rekomandim i këtij Komiteti.

Pra vetëm kaq kisha me qëllim që të mos ndodh kjo papërgjegjësi ndaj këtij komuniteti dhe ndaj të gjitha komuniteteve në përgjithësi.

z.Benjamin Ejupi, theksoi, fillimisht e falënderoj shefin e ZKKK z.Liman Zeqiri për angazhimin e tij rreth kësaj çështjeje si dhe i mbështes rekomandimet e dhëna, duke kërkuar që të njëjtat të adresohen në drejtoritë përkatëse sa më shpejt që të jetë e mundur.

znj.Albina Avdiu, Kryesuese e Komitetit, theksoi, vetëm desha t’ju informoj se në bazë të informatave që kam, Shoqata “Bereqeti” do të ndihmoj me pako ushqimore-higjienike dhe ndihma tjera familjet në nevojë të komuniteteve jo shumicë, por pa përjashtuar edhe ato të komunitetit shumicë.

Meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën e konsideroj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës me konstatimin që si Komitet për Komunitete të kemi një deklaratë – rekomandim për drejtoritë dhe sektorët tjerë që sa më shpejt të jetë e mundur t’iu dilet në ndihmë familjeve në nevojë, qoftë me dru për ngrohje, qoftë me pako ushqimore dhe ndihma tjera të nevojshme.

3. Të ndryshme

*Nuk pati të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën,
Kryesuesja e Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.*

Mbledhja përfundoi në orën 11:10

**Procesverbalin e mbajti
Enis Sheholli**

**Nr. 01-060/04-0075663/20
Podujevë,
14 dhjetor 2020**

**Kryesuese e Komitetit
Albina Avdiu**